



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 247/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-04187-01-17-2019, me objekt, “Kryerja e shërbimit të ruajtjes me roje private në SUT”, me fond limit 27.018.748 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 15.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtim i arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë, “Myrto Security” sh.p.k., “Leksi Security” sh.p.k., “Oktapus” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtim i arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë, “Myrto Security” sh.p.k., “Leksi Security” sh.p.k., “Oktapus” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

“Toni Security” sh.p.k.

Rruga “Lidhja e Prizrenit”, Njësia Bashkiake Nr.5, Pll. 10/1, Kati I, Tiranë

“Eurogjici Security” sh.p.k.

Rruga “Adem Jashari”, Lagja nr.8, H.10, Ap.3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Universitar i Traumës

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.01.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-04187-01-17-2019, me objekt, “Kryerja e shërbimit të ruajtjes me roje private në SUT”, me fond limit 27.018.748 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 15.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Në datën 15.02.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 25.02.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Eurogjici Security” sh.p.k.	25.642.881,23 lekë, skualifikuar
2. “Leksi Security” sh.p.k.	25.651.519,54 lekë, skualifikuar
3. “Toni Security” sh.p.k.	25.651.519,54 lekë, skualifikuar
4. “International Security Albania” sh.p.k.	25.651.519,54 lekë, kualifikuar
5. “Myrto Security” sh.p.k.	25.651.519,54 lekë, skualifikuar
6. “Oktapus” sh.p.k.	25.660.618 lekë, skualifikuar
7. “Nazeri 2000” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 25.02.2019, operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

OE nuk ploteson kriteret e kerkuara:

1-deklarata e gjendjes gjyqesore nuk eshte plotesuar me drejtuesin teknik sipas deklarimeve ne ekstrakin tregetar.

2-Drejtuesi teknik i deklaruar ne shtojcen per permbushjen e kriterëve te pergjithshme ne lidhje me gjendjen gjyqesore nuk figuron ne ekstraktin tregtar te shoqerise.

3- Drejtuesi teknik ne detyre nuk ka certifikaten e drejtuesit teknik sipas kerkesave.

4-Autorizimi i leshuar nga akep nuk eshte per periudhen kohore per te cilen eshte parashikuar te kryhet zbatimi i kontrates pasi mbaron ne 31.12.2019, ndersa kontrata do te jete per nje periudhe kohore 12 mujore nga nenshkrimi i saj.

5- nuk ka grup te gatshem per te tre turnet pasi sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018 , kreu 5 menaxhimi i sherbimeve, pika 13 duhen min 2 persona per cdo turn. Sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24ore) dhe 12 muaj sherbim sipas kerkeses.

6-Numri i punonjesve te sherbimit te certifikuar dhe te deklaruar nuk perputhet me numrin e punonjesve te sherbimit sipas kontratave te sherbimit te deklaruar ne drejtorine e policise

7-Sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018, duhen certifikatat e specjaltetit per pergjegjesit e sherbimit, operatorët e sallave dhe verifikuesve te sinjalit. Sipas modelit 12 te tij.

II.4.1. Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k. në datën 28.02.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k. si dhe kërkon të mbeten të skualifikuar operatorët ekonomikë “Myrto Security” sh.p.k., “Leksi Security” sh.p.k. dhe “Oktapus” sh.p.k.. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:

[...] 1-Kundërshtojmë arsyen e parë të skualifikimit që ka të bëjë me... “1-deklarata e gjendjes gjyqesore nuk eshte plotesuar me drejtuesin teknik sipas deklarimeve ne ekstrakin tregetar”. Procedura e prokurimit është zhvilluar në datë 15.02.2019. Krahas dokumentacionit tjetër të ngarkuar ne SPE, shoqëria jonë ka ngarkuar dhe ekstraktin historik të datës 12.02.2019, pra dy ditë përpara zhvillimit të procedurës ku rezulton si drejtues teknik Z. Ferit Hoxha. Pra në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, rezulton si drejtues teknik I shoqërisë tonë z. Ferit Hoxha për rrjedhojë edhe shtojca deklarata e gjendjes gjyqësore eshte plotësuar me kete drejtues teknik. Ndërkohë që deklarimi në QKB nga shoqëria jonë, mbi të cilin është bazuar autoriteti kontraktor është kryer në datën 20.02.2019, pra 5 ditë pas mbylljes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, për rrjedhojë këto levizje nuk mund të merren për bazë gjatë vlerësimit të dokumentacionit të kësaj procedure. Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...].

Nga sa më sipër, arsyeja e skualifikimit të shoqërisë tonë është tërësisht në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit, gjendjen në QKB në datën e zhvillimit të procedurës (15.02.2019), legjislacionin në fuqi për rrjedhojë duhet të anulohet.

2- Kundërshtojmë arsyen e dytë të skualifikimit që ka të bëjë me... “2-Drejtuesi teknik i deklaruar ne shtojcen per permbushjen e kriterëve te pergjithshme ne lidhje me gjendjen gjyqesore nuk figuron ne ekstraktin tregtar te shoqerise”. Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit si tërësisht të pa bazuar dhe tërësisht diskriminuese. Procedura e prokurimit është zhvilluar në datë 15.02.2019. Krahas dokumentacionit tjetër të ngarkuar ne SPE, shoqëria jonë ka ngarkuar dhe ekstraktin

historik të datës 12.02.2019, pra dy ditë përpara zhvillimit të procedurës ku rezultojn si drejtues teknik Z. Ferit Hoxha. Pra në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, rezultojn si drejtues teknik I shoqërisë tonë z. Ferit Hoxha I cili figuron në ekstraktin e QKB. Ndërkohë që referuar QKB së shoqërisë tonë, drejtuesi teknik i shoqërisë sonë është larguar në datën 20.02.2019, pra pas datës së zhvillimit të procedurës objekt ankimi.

Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...].

Nga sa më sipër, rezultojn se skualifikimi I shoqërisë tonë nuk është I bazuar në dokumentat standart të tenderit. Për sa më sipër, skualifikimi është i paligjshëm.

3- Kundërshtojmë arsyen e tretë të skualifikimit se ... “Drejtuesi teknik në detyrë nuk ka certifikatën e drejtuesit teknik sipas kërkesave”.

Referuar kriteret e vecanta të kualifikimit, rezultojn të jetë kërkuar:

a- Licencë e konform ligjit nr. 75/2014 për “Sherbimin privat të Sigurisë Fizike” e nënkategorisë 1.3.A, Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”;

c- Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;

Në përmbushje të kërkesës së mësipërme, shoqëria jonë ka ngarkuar në SPE, dokumentacionin në vijim:

1- Licencë QKB, miratuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit me vendim nr. 342/6;

2- Vendimin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit Nr. 342/6

3- Çertifikatën e Drejtuesit Teknik Nr. 63/4, datë 26.01.2016 për z.Ferit Hoxha.

Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezultojn se seti i dokumentacionit të ngarkuar nga ana jonë në SPE është tërësisht sipas legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë skualifikimi I shoqërisë tonë nuk është I bazuar në dokumentat standarte të tenderit. Për sa më sipër, skualifikimi është i paligjshëm.

Kundërshtojmë arsyen e katërt të skualifikimit se... “Autorizimi i leshuar nga akep nuk është për periudhën kohore për të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës pasi mbaron në 31.12.2019. ndërsa kontrata do të jetë për një periudhë kohore 12 muje nga nënshkrimi i saj”. Në kriteret e vecanta është kërkuar: Autorizim individual për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi, leshuar nga A.K.E.P në emër të shoqërisë, konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, me zone mbulimi Bashkinë e Tiranës. Periudha e vlefshmerisë së Autorizimit/ dokumentacioni duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës (viti 2019).” Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

-Licencën Nr. 1839, datë 27.11.2014 për Sistem Radiokomunikimi dhe Sistem Radioalarmi me zonë mbulimi Qarkun Tiranë 45 Km, me afat për të gjithë vitin 2019.

Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezultojn se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi I shoqërisë sonë është I bazuar në kriteret të pa kërkuara e për rrjedhojë duhet të anulohet. Sa më sipër skualifikimi është I paligjshëm.

4-Kundërshtojmë arsyen e pestë të skualifikimit që ka të bëjë me... “5-nuk ka grup të gatshëm për të tre turnet pasi sipas udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018, kreu 5 menaxhimi i shërbimeve, pika 13 duhen min 2 persona për çdo turn. Sipas përlogaritjeve dhe parashikimeve në kodin e punës duhen

$4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24ore) dhe 12 muaj sherbim sipas kërkeses”. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“1.Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”

Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

- Vërtetim Nr.178/72 prot, datë 13.02.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me anë të të cilit theksohet se shoqëria jonë disponon Grup të Gatshëm Turni I, II dhe III.

Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezulton se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi i shoqërisë tonë është i bazuar në kriteret të pa kërkuara e për rrjedhojë duhet të anulohet. Skualifikimi I shoqërisë tonë nuk është i bazuar në dokumentat standarte të tenderit por në justifikime me qëllim favorizimin e shoqërisë “International Security Albania”. Nuk vendos KVO se sa duhet grupi I gatshëm 24 orësh por DVP Tiranë si organi i ngarkuar nga ligji për mbikëqyrjen e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike. Akoma më tej, edhe sikur të pranojmë për një moment se justifikimi I KVO qëndron (NUK QËNDRON) se... “Sipas përlllogaritjeve dhe parashikimeve në kodin e punës duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona për 3 turne (24 ore)”, sqarojmë se nëse do të pranojmë këtë logjikë, na rezulton se për shërbimin 24 orësh nuk duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona për 3 turne por 4.98×3 turne (Grup gatshem 24 ore) = 14.94 persona për 3 turne. Pra edhe njëherë duket qartë përpjekja e autoritetit kontraktor për të manipuluar kriteret e vecanta të kualifikimit duke i interpretuar ato sipas oreksit dhe interesave korruptive që ka me shoqërinë e vetme të kualifikuar “International Security Albania” e cila në vërtetimin e policisë disponon 10 punonjës për punonjësit e verifikimit të alarmit. Nëse do I qëndrojmë përlllogaritjes së autoritetit kontraktor atëherë duhet të skualifikohet edhe shoqëria “International Security Albania” sh.p.k. e cila nuk disponon 14.94 persona për 3 turne (Grup Gatshem 24 ore) por disponon vetem 10 persona per tre turne (Grup Gatshem 24 ore). Për sa më sipër skualifikimi është i paligjshëm.

VI- Kundërshtojmë arsyen e gjashtë të skualifikimit se... “Numri i punonjesve te sherbimit te certifikuar dhe te deklaruar nuk perputhet me numrin e punonjesve te sherbimit sipas kontratave te sherbimit te deklaruar ne drejtorine e policise.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

“1.Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- *Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)*
- *Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi*
- *Ka grup te gatshem 24 ore*
- *Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit*
- *Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018*
- *Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018*
- *Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018*
- *Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”*

Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

Vërtetim Nr.178/72 prot, datë 13.02.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me anë të të cilit theksohet se [...]. Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...].

Nga sa më sipër, rezulton se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi i shoqërisë tonë është teresisht i dashakeq për arsye se numri 181 është lapsus pasi me shkrim ky numër është (njëqind e tetedhjet e katër) dhe referuar dokumentave standarte te tenderit kur ka mospërputhje midis shifrave dhe përshkrimit me shkrim të saj, kjo e fundit do të merret për bazë. Për sa më sipër, skualifikimi është i paligjshem dhe duhet të anulohet.

VII- Kundërshtojmë arsyen e shtate të skualifikimit se... “7-Sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018, duhen certifikatat e specialitetit per pergjegjesit e sherbimit, operatoret e sallave dhe verifikuesve te sinjalit. Sipas modelit 12 te tij”. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“1.Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- *Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)*
- *Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi*
- *Ka grup te gatshem 24 ore*
- *Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit*
- *Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018*
- *Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018*
- *Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018*
- *Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”*

Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

Vërtetim Nr.178/72 prot, datë 13.02.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me anë të të cilit theksohet se shoqëria jonë disponon operator salle minimalisht 5, Përgjegjës Shërbimi 2, Grup të gatshëm 24 orësh. Nga sa më sipër, del qartë se në kriter nuk është kërkuar paraqitja e certifikatave të pretenduara nga autoriteti kontraktor dhe shoqëria jonë nuk i ka paraqitur ato. Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezulton se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi i shoqërisë tonë është i bazuar në kritere të pa kerkuara e për rrjedhojë duhet të anulohet.

7. Kundershtojme kualifikimin e operatori ekonomik "Internacional Security Albania" shpk, per arsyet ne vijim:

1.Operatori ekonomik ka nderhyre ne formularin e ofertes duke e modifikuar ate te publikuar ne DST. Ne Dst formulari i ofertes është:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroj eve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se _____	(X)	(X)	(X)	(X)	(X)
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					(X)
	Oferta total					(X)

Ndërkohë që operatori ekonomik ka ndryshuar këtë formular dhe ka paraqitur një formular tjetër të ndryshëm nga ai i DST-ve. Ka ndërhyrë në formular duke shtuar rreshta dhe duke e ndryshuar totalisht atë nga formulari I kërkuar nga autoriteti kontraktor. Operatori ekonomik është i detyruar të plotësojë ofertën në përputhje të plotë me dokumentat standarte të tenderit dhe cdo ofertim në kundërshtim me to, përbën kusht për skualifikim. Nëse operatori kishte paqartësi ai ishte në të drejtën e tij të përdorte procedurën ligjore të kërkesës për sqarim të parashikuar në LPP.

2. Operatori ekonomik ka ndryshuar preventivin e kerkuar nga Autoriteti kontraktor duke i shtuar rreshta.

3. Edhe në rastin e preventivit për një vendroje me një turn është ndryshuar totalisht preventive duke hequr dy rreshtat e shtesave të turneve dhe duke shtuar rreshta të tjerë të pakërkuar nga autoriteti kontraktor në dst. Operatori ekonomik është i detyruar të plotësojë ofertën në përputhje të plotë me dokumentat standarte të tenderit dhe cdo ofertim në kundërshtim me to, përbën kusht për skualifikim.

4. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur analizën e kostos te plotë me përlllogaritje konkrete aritmetikore. Në analizë nuk ka perlllogaritur ne analizen e kostos vleren totale per nje roje ne muaj, vleren per nje vendroje ne muaj si dhe totalin e vleres per numrin total te rojeve dhe afatit te percaktuar. Ne asnje nga Analizat e dy vendrojave nuk jane bere keto llogaritje. Gjithashtu nuk eshte paraqitur ne Analizen e kostos as totali i vleres per te gjitha vendrojet dhe per afatin e percaktuar.

5. Akoma me tej, nje nder arsyet e skualifikimit te shoqerise sone ishte se... “Sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24 ore). Referuar dokumentave te tenderit, rezulton se sherbimi eshte me tre turne pra 24 ore dhe jo me dy turne per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga DVP-Tirane, per operatorin ekonomik "Internacional Security Albania" shpk, nuk permбан punonjes per grup te gatshem 14.94 punonjes sherbimi (4.98×3 Turne(Grup Gatshem 24 ore)= 14.94 persona por më pak se ky numer. Pra, edhe njëher duket qartë përpjekja e autoritetit kontraktor për të favorizuar këtë operator.

6. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: “1. Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”

Ne permbushje te keti kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur: “Vertetim leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane me ane te cilit jepet informacion se Subjekti nuk ka mase administrative (gjoke) POR nuk jep informacion nese ka patur mase administrative ose Jo per Drejtuesin Teknik, kerkese e cila eshte kerkuar ne menyre eksplicide nga autoriteti kontraktor. Per kete arsye operatori duhe te skualifikohet pasi nuk përmbush kriterin kualifikues.

7. Data e certificates se drejtuesit teknik te kesaj shoqerie eshte 06.07.2011 nderkohe qe eshte korrigjuar duke e bere 06.07 2015. Pra, kemi te bejme me dokument te skaduar pasi afati I kesaj certificate eshte 4 vjet nga data e leshimit per rrjedhoje nje dokument te pasakt në kuptim të dokumentave standarte të tenderit. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, eshte theksuar ne menyre taksative se: Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Raster e mos- dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

8. Referuar Ekstraktit te shoqerise, rezulton se drejtuesi teknik i shoqerise eshte njeheresh edhe administrator cka bie ne kundërshtim me ligjin Nr 75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise" ku thuhet se drejtuesi teknik duhet të jetë me kohë të plotë pune. Ne nenin 14, shkronja c) te "Ligjit Nr. 75/2014 "Per SHPSF" theksohet ne menyre taksative se: "drejtuesi teknik te jete i pajisur me certifikaten e nenkategorise 1.3.A dhe te jete me kohe te plote pune." Ne rastin konkret drejtuesi teknik nuk është me kohë të plotë pune pasi ai është I ngarkuar edhe me një detyrë tjetër atë si administrator i shoqërisë.

9. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: OE ofertues duhet te kete ne stafin e tije te pakten 1 (nje) inxhinier elektronik ose Inxhinier IT i cili te figuroje ne listpagesat e shoqerise. Per te vertetuar kete kriter, OE duhet te paraqese diplome dhe kontrate te vlefshme pune.

Ju sqarojme se:

Operatoret Ekonomike pjesmarres duhet te permbushin kerkesat ligjore sipas Ligjit Nr. 19/2016 PËR MASAT SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE si dhe UDHËZIM Nr.134, datë10.3.2017 “PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË MASAVE SHITESË TË SIGURISË DHE LLOJIN MASAVE QË DUHET TË MARRIN SUBJEKTET NË VARËSI TË AKTIVITETIT APO VLERËSIMIT TË RREZIKUT, SI DHE PROCEDURAT E NJOFTIMIT TË TYRE”.

AK, për të përmbushur vendimin e lënë nga “DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLICISE SE SHTETIT DREJTORIA VENDORE E POLICISE TIRANE” me shkrese Nr 1885 me date 06.03.2018 dhe protokolluar nga Spitali Univeristar i Traumes me Nr.503 me date 21.03.2018, do te kerkoje, ne kontraten e lidhur me OE te shpallur fitues, qe te monitoroje me kamera territorin e SUT dhe per te realizuar kete duhet te permbushje dhe kriterin e kerkuar me siper (OE ofertues duhet te kete ne stafin e tije te pakten 1 (nje) inxhinier elektronik ose Inxhinier IT i cili te figuroje ne listpagesat e shoqerise). Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e shërbimit por nuk ka paraqitur asnjë licence për të vertetuar se ky person është i licencuar pra ka të drejtë ligjore për të ofruar këtë shërbim.

10. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: “6.OE duhet te disponoje te pakten 7 arme (arme brezi) per te siguruar 7 vendrojet me sherbim 24 oresh sipas specifikimeve teknike ne DT. Per te vertetuar kete pike, OE pjesmarres duhet te paraqesin autorizim/vertetim nga Drejtoria e Policise.” Operatori ekonomik ka dështuar në përmbushje të këtij kriteri pasi nuk ka paraqitur autorizim nga DVP-Tiranë.

11. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitet 2017 dhe 2018, leshuar nga njesite e Qeverisjes Vendore ku OE eshte I regjistruar. Kur konkurrimi behet bashkim operatoresh, secili OE do te sjelle vertetim me vete”. Referuar Ekstraktit te shoqerise, rezulton se operatori ekonomik ne daten 21.04.2015, ka hapur adresen: "Tirane, Njesia Bashkiake 9, Bulevardi Zogu i Pare, Pallati Nr 55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap. 9" si në vijim. Ne permbushje te kriterit te mesiperm, referuar informacioneve nga Bashkia, rezulton se operatori ekonomik disponon dhe ka paraqitur dokumentacionin si ne vijim: Vertetim leshuar nga Bashkia Tirane, me ane te se ciles vertetohet vetem shlyerja e taksave vendore per vitet 2015-2016-2017 dhe 2018 per te gjitha adresat ku ka ushtruar aktivitet. Ndërkohë që ky vërtetim nuk ka vertetuar se ka shyer taksat vendore per vitet 2017-2018 per adresen ku ushtron aktivitet. Nga sa me siper, rezulton se operatori ekonomik ka deshtuar ne permbushjen e kriterit kualifikues, për arsye se për adresën "Tirane, Njesia Bashkiake 9, Bulevardi Zogu i Pare, Pallati Nr 55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap. 9", adresë e cila është aktive ende, nuk ka vërtetuar se ka shyer taksat vendore për vitin 2017-2018.

12. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: “3.Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Tetor, Nentor, Dhjetor 2018), shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 44 punonjës të siguruar në muaj, përfshirë punonjësit e shërbimit roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Rezulton se personi qe kryen funksionin e drejtuesit teknik dhe njehekosisht te administratorit nuk eshte i siguruar ne listpagesat e shoqerise ne te dy pozicionet ate te drejtuesit

teknik dhe administratorit. Pra, operatori ekonomik nuk e ka permbushur kriterin e vecant te kualifikimit i cili ka kerkuar ne menyre taksative qe te jete i perfshire drejtuesin teknik dhe administratorin.

13. Operatori ekonomik nuk disponon 44 punonjes me certifikata te vlefshme Brenda afatit 4 vjecare te percaktuar ne nenin 5 te ligjit Nr 75/2014, date 10.07.2014 "Per SHPSF".

14. Certifikatat e punonjesve te sherbimit te paraqitur nga operatori ekonomik nuk figurojne te gjitha ne listpagesat e shoqerise.

15. Rezulton se procedura e prokurimit objekt ankese eshte hapur ne daten 15.02.2019, nderkohe qe ne faqen zyrtare te Komisionit te Prokurimeve Publike eshte publikuar Njoftimi Nr. 233 Prot, date 14.02.2019 "Rekomandim mbi menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit per sherbimin privat te ruajtjes fizike" thuhet se: Ne procedurat me afat 1 vjecar ku perfshihet edhe muaji shkurt i vitit 2020 si vit i brishte, mesatarja mujore duhe te perlllogarit 30.5 dite ne muaj;

Nderkohe qe referuar diteve mesatare te perlllogaritura nga operatori ekonomik nuk jane kryer me 30.5 dite ne muaj per kete arsye duet te skualifikohet.

IX). Kerkojme lenien e skualifikuar te operatoreve ekonomike "Myrto Security" shpk, Leksi Security" shpk dhe "Oktapus" shpk dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit si ne vijim:

"MYRTO SECURITY" SHPK

1. Operatori ekonomik ne Formularin e Ofertes ekonomike ka gabime aritmetike te cilat kalojn vleren 2% dhe oferta duhet te skualifikohet pasi ne rastin konkret nuk pranohen korrigjime te gabimeve aritmetike te cilat e kalojne kete vlere. Ne DST eshte theksuar se: nese ka mosperputhje ndermjet cmimit njesi dhe vleres se pergjithshme qe merret nga shumezimi i cmimit njesi dhe sasise, atehere do te mbizoteroje cmimi njesi, dhe rrjedhimisht duhet te korrigjohet shuma ne total. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute te te gjitha korrigjimeve jane me shume se 2% e vleres se ofertes ekonomike te ofruar.

Sipas ofertes se Operatorit ekonomik, nese shumezojme cmimin per njesi me afatin dhe sasine del vlere 110,119,891.24 leke (per vendrojen 24 ore). Pra $12 \times 7 \times 4.98 \times 263,243.19 = 110,119,891.24$ leke dhe jo 22,112,428.66 leke sic eshte llogaritur nga OE. Diferenca midis vleres se sakte dhe vleres se llogaritur nga OE eshte 88,007,462.58 leke ($110,119,891.24$ leke - $22,112,428.66$ leke = $88,007,462.58$ leke), vlere kjo me e larte se 2% e vleres ekonomike te ofruar. (2% e vleres se ofruar eshte = $22,112,428.66$ leke $\times 2\% = 442,248.57$ leke). Diferenca 88,007,462.58 leke eshte > 442,248.57 leke dhe per kete arsye oferta skualifikohet.

2) Gjithashtu ne rastin e vendrojeve me sherbim 8 ore ka gabim aritmetik, me vlere me te larte se 2% e vleres se ofruar. Sipas logaritjeve te sakta: $12 \times 6 \times 1.08 \times 49,154.04 = 3,822,218.15$ leke dhe jo 3,539,090.88 leke sic eshte llogaritur nga OE. Diferenca midis vleres se sakte dhe vleres se llogaritur nga OE eshte 283,127.27 leke ($3,822,218.15$ leke - $3,539,090.88$ leke = $283,127.27$ leke), vlere kjo me e larte se 2% e vleres ekonomike te ofruar (2% e vleres se ofruar eshte = $3,539,090.88$ leke $\times 2\% = 70,781.81$ leke)

3) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Analizen e kosos te plote me perlllogaritje konkrete aritmetikore pasi ne Analize nuk ka llogaritur vleren totale per vendrojet me 4.98 roje dhe me 1.08 roje per 12 muaj si dhe totalin e pergjithshem per numrin total te rojeve dhe afatin e percaktuar. "OKTAPUS" SHPK

1) Rezulton se ky operator ka mase administrative ne vertetimin e leshuar nga DVP-Tirane.

2) Operatori ekonomik ka ndryshuar formularin e ofertes te percaktuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit. OE ka shtuar një kolonë duke e bërë formularin e ofertës me 8 kolona, ndërkohë që

në DST është me 7 kolona. Pra ka shtuar "Cmimi Vendroje/muaj" i cili nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor në DST dhe kjo përbën ndërhyrje në dokumentat e tenderit. Pra, oferta nuk është bere ne perputhje me kerkesat e Autoritetit kontraktor.

3) Operatori ekonomik ka ndryshuar preventivin e kerkuar nga Autoriteti kontraktor duke I shtuar dy rreshta e fundit.

4) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Analizen e kostos te plote me perlllogaritje konkrete aritmetikore pasi ne Analize nuk argumentohet aspak se si eshte perlllogaritur vleren totale per nje roje ne muaj, vleren per nje vendroje ne muaj si dhe vleren totale per te gjitha vendrojet dhe afatin e kerkuar.

5) Ne preventivin per vendrojet turni i pare, ka lene bosh (pa plotesuar dhe pa argumentuar) 2 rreshtat e shtesave te turneve te cilat jane te detyrueshme per tu plotesuar dhe argumentuar sipas kerkeses se Autoriteti kontraktor ne DST, Shtojca 1-Sqarime. Gjithashtu ka nderhyre ne kete preventiv duke shtuar 2 rreshtat e fundit te cilet nuk jane ne preventivin e kerkuar.

"LEKSI SECURITY" SHPK

1) Ka mase administrative ne DVP-Tirane.

2) Përshkrimi I kontratës është bërë gabim pasi në DST është "Kryerja e shërbimit të ruajtjes me roje private në SUT" – Marrëveshje kuader- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj. Operatori ekonomik në përshkrimin e kontratës ka përcaktuar "Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT".

3) Operatori ekonomik ka ndryshuar preventivin e kerkuar nga Autoriteti kontraktor duke I shtuar dy rreshtat e fundit.

4) Ne preventivin per vendrojet turni i pare, ka hequr 2 rreshtat e shtesave te turneve te cilat jane te detyrueshme per tu plotesuar dhe argumentuar sipas kerkeses se Autoriteti kontraktor ne DST Shtojca 1-Sqarime. Gjithashtu ka nderhyre në preventiv duke shtuar 2 rreshtat e fundit te cilet nuk jane ne preventivin e kerkuar.

5) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Analizen e kostos te plote me perlllogaritje konkrete aritmetikore pasi ne Analize nuk ka llogaritur vleren totale per 7 vendroje me tre turne per 12 muaj, vleren totale per 6 vendroje me nje turn për 12 muaj si dhe vleren totale per te gjitha vendrojet dhe afatin e kerkuar. Perfundimisht, kerkoje:

1) Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses.

2) Kualifikimin e shoqerise sone, sipas arsyetimit te dhene me siper.

3) Skualifikimin e operatorit ekonomik "Internacional Security Albania" shp k, sipas referimeve te mesiperme.

4) Lenien e skualifikuar te operatoreve ekonomik "Myrto Security" shpk, "Leksi Security" shpk dhe "Oktapus" shpk, sipas referimeve te mesiperme.

5) Kthim Pergjigje brenda afateve te parashikuara ne nenin 63 te LPP-se.

II.4.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 04.03.2019, me anë të shkresës nr.633/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

"[...]Për sa i përket ankesës suaj në lidhje me pikën e parë të saj, ku ankoheni se: arsyeja e skualifikimit është tërësisht në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit, gjendjen në QKB në datën e zhvillimit të procedurës (15.02.2019) dhe legjislacionin në fuqi, sqarojmë se: Arsyeja e

skualifikimit për pikën 1 ka të bëjë me kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe jo ato të vecanta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatojmë se është kërkuar që OE ofertues duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit si më poshtë: Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit [...]

Sipas ketyre kërkesave, KVO ka verifikuar vetedeklarimin e plotësuar nga OE "Toni Security" dhe ka konstatuar se drejtuesi teknik nuk është i njëjti me atë që figuron në Ekstraktin historik të shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-se se janë bërë ndryshimet e drejtuesve teknik (ka ikur Z.Ferit Hoxha dhe është emëruar z. Luan Shehu si drejtues teknik I shoqërisë nga data 15.02.2019). Bazuar në këtë informacion, KVO ka vlerësuar se nuk ka të dhëna për drejtuesin teknik të emëruar datën e zhvillimit të procedurës. Mungon vetedeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës dhe nenit 45 dhe 45/1 të LPP. Për këtë arsye KVO ka vlerësuar se nuk përmbushen kërkesat e AK përsa i përket kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Mbase shqyrtuam këtë informacione, KSHA arsyeton se pretendimet e OE "Toni Security" nuk janë të bazuara në fakte dhe nuk përmbushen kërkesat e përgjithshme të kualifikimit. OE pjesëmarrës duhet të merrnin masë për të plotësuar kushtet e kualifikimit në tender kohe përpara se të zhvillohej procedura në mënyrë që të ketë vlerësim mbi dokumentat e faktit sipas kërkesave në DT. Ndryshimet e ndodhura në datën e zhvillimit të tenderit krijojnë mangësi në dokumentacion dhe për pasoje KVO ka skualifikuar OE që nuk plotësojnë kërkesat e publikuara në DT. KVO ka vlerësuar OE sipas dokumentacionit që ka publikuar në sistemin elektronik të APP-se dhe sipas verifikimeve të vetedeklarimeve sipas shtojcës Nr.8: "Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër". Për këtë arsye KSHA vendosi që të mos e marrë parasysh ankesën e OE "Eurogiici-Security" dhe të lere në fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

2. Përsa i përket pikës së dytë të ankesës së OE "Toni- Security" ku ankohet për skualifikim të padrejtë në lidhje me drejtuesin teknik I deklaruar në shtojcën për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme në lidhje me gjendjen gjyqësore I cili nuk figuron në ekstraktin tregëtar të shoqërisë. Sipas pretendimeve të OE, kërkesat e publikuara I shërbejnë AK-se për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE deri në datën e hapjes së ofertave Bazuar në pretendimet e paraqitura në ankese ju sqarojmë si më poshtë Vetedeklarimi I paraqitur nga OE "Toni- Security" shpik është për drejtuesin teknik të larguar nga kjo detyrë (sipas ekstraktit në QKB) dhe jo për drejtuesin teknik që aktualisht figuron i punësuar në këtë shoqëri. Për këtë arsye KVO e ka quajtur të pa përmbushur këtë kërkesë sipas kriterëve të kualifikimit.

Ju bëjmë me dije se AK nuk vlerëson dokumentacionin që verteton historikun e ofertuesve por vlerëson në bazë të dokumentacionit që shërben për të vertetuar që ky operator ka paraqitur dokumentacion që të marrëveshjes Kuader që do të lidhet për një periudhë 12 muajve verteton reallizimin me sukses nga data e lidhjes së kësaj marrëveshjeje Si rrjedhojë KVO ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur sipas kriterëve të përgjithshme dhe ato të vecanta të kualifikimit ku duhet të vertetohen që drejtuesi teknik është i padënuar sipas Nenit 45/1 të LPP.

Drejtuesi teknik aktual nuk figuron në vetedeklarimet e OE dhe si rrjedhojë është e pa përmbushur kjo kërkesë e kriterëve të kualifikimit. Për këtë arsye KSHA vendosi që të mos e marrë parasysh ankesën e OE "Toni-Security shpik dhe të lere në fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

3. Për pikën tretë ku kundërshtohet arsyeja e skualifikimit e cila ka të bëjë me drejtuesin teknik pasi dokumentacioni i ngarkuar nga OE në SPE është teresisht sipas legjislacionit në fuqi sqarojmë se: Certifikata e drejtuesit teknik të paraqitur nga OE "Toni -Security" shpik është për

drejtuesin teknik te larguar nga kjo detyre (sipas ekstraktit ne QKB) dhe jo per drejtuesin teknik qe aktualisht figuron i punesuar ne kete shoqeri. Per kete arsye kvo e ka quajtur te pa permbushur kete kerkese sipas kriterëve te kualifikimit. OE duhet te dokumentojë se permbush kerkesat e AK deri ne momentin e vleresimit te dokumentacionit nga ana e Kvo-se dhe duhej te kishte mare masat e nevojshme qe te bente ndryshimet perkatese perpara hapjes se procedures nga AK. Duke bere ndryshimet e drejtuesve teknik ku ne daten 15.02.2019 figuron si drejtues teknik Luan shehu, OE ka bere te pamundur vertetimin e dokumentacionit per drejtuesin teknik aktual i cili figuron ne ekstraktin e shoqerise. Per keto arsye KSHA vendosi qe te mos e marre parasysh ankesen e OE "Toni-Security" dhe te lere ne fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

4. Per sa i perket pikes se katert ku ankoheni se jeni skualifikuar pa te drejte ne lidhje me autorizimin e leshuar nga AKEP, i cili nuk eshte per periudhen kohore per te cilen eshte parashikuar te kryhet zbatimi i kontrates pasi mbaron ne 31. 12. 2019, ndersa kontrata do te jete per nje periudhe kohore prej 12 muaj nga nenshkrimi i saj, sqarojme se:

OE pretendon se I ka permbushur kerkesat e AK lidhur me kete pike pasi ka paraqitur licence e kerkuar per gjithë viti 2019. Ne kriteret e kualifikimit eshte kerkuar: Kapaciteti teknik pika nr 2. "Autorizim individual per caktim frekuencash per sistem radiokomunikimi, leshuar nga A K.E.P ne emer te shoqerise, konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008, me zone mbulimi Bashkine e Tiranes. Periudha e vlefshmerise se Autorizimit/ dokumentacioni duhet te mbuloje periudhen kohore ne te cilen eshte parashikuar te kryhet zbatimi i kontrates (viti 2019). Sipas kerkesave te mesiperme rezulton se eshte kerkuar qe OE pjesmarres te paraqesin dokumentacion ku periudha e vlefshmerise te mbuloje periudhen kohore te zbatimit te kontrates nnderkohe qe ne kllapa eshte vendosur viti 2019. Ju bejme me dije se qellimi I AK eshte te vertetohet qe OE Pjesmarres te vertetojne realizimin me sukses te kontrates dhe kjo eshte e shprehur ne menyre te qarte. Kerkesat e vendosura ne kllapa nuk shfuqizojne kerkesen dhe vullnetin e Ak I cili eshte I shprehur qartesisht. KVO ka vleresuar se OE nuk e permbush kete pike te kriterëve teknik te kualifikimit pasi licenca e paraqitur nuk mbulon nje periudhe te Marrveshjes Kuader. Per keto arsye KSHA vendosi qe te mos e mare parasysh ankesen e OE "Toni- Security" shpk dhe te lere ne fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

5. Per piken se peste ku kundershtohet arsyeja e skualifikimit ne lidhje me kriteret e vecanta Kapaciteti teknik ku shkruhet se OE nuk ka grup te gatshem me tre turne pasi sipas udhezimit nr 130 date 05.03.2018 kreu V, menaxhimi i sherbimeve, pika 13 ku citohet se duhen minimum 2 persona per cdo turn ku sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per tre turne (24 oresh)dhe 12 muaj sherbim sipas kerkeses, sqarojme se:

OE pretendon se ka permbushur kriterin e kerkuar pasi ne vertetimin e policise figuron qe kjo shoqeri ka grup punonjesish per verifikimin e sinjalit te alarmit. KVO ka vleresuar se nje grup I gatshem duhet te kete minimum 2 punonjes sherbimi ne cdo turn sipas legjislacionit ne fuqi (sipas udhezimit nr 130 date 05.03 2018 kreu V, menaxhimi I sherbimeve, pika 13 ku citohet se duhen minimum 2 persona per cdo turn). Nisur nga kjo Kvo ka bere perlllogaritjet e punonjesve qe duhen per nje grup te gatshem me tre turne per 24 ore dhe 365 dite ne vit. Sipas koficientit te zevendesimit duhen 1.66 punonjes per cdo turn ne nje sherbim 24 oresh dhe 4.98 punonjes per tre turne KVO ka verifikuar nr e rojeve te grupit te gatshem per cdo turn (2 roje) dhe e ka shumezuar me koficientin e rojeve duke vleresuar se duhen 9.96 punonjes (roje) per nje grup te gatshem I cili mund te permbushe kerkesat e AK per nje sherbim 24 resh ne 365 dite.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjykon se perlllogaritja e bere nga ana e kvo-se eshte e bazuar ne kerkesat e AK per nje sherbim 24 oresh ne 365 dite. Për këto arsye KSHA vendosi që të mos marrë parasysh ankesën e OE “Toni Security” dhe te lere ne fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

6. Per kundershkrimin e OE ne lidhje me piken e gjashte te ankeses e cila ka te beje piken nr 5-Numri i punonjesve te sherbimit te certifikuar dhe te deklaruar nuk perputhet me numrin e punonjesve te sherbimit sipas kontratave te sherbimit te deklaruar ne drejtorine e policies sqarojme se KVO ka verifikuar nje paqartësi në vërtetimin e leshuar nga DVPT ku nr I punonjesve të shërbimit figuron i shkruar për njëqind e tetëdhjete e katër punonjës, ndërkohë që nr është 181 punonjës. Lidhur me këtë pikë gjykojmë se ankesa e OE qëndron pasi numri I shprehur me shkronja është I qartë dhe mund te jete berë gabim shkrimi nga ana e DVPT. Për këtë arsye KSHA vendosi që të marre parasysh ankesen e OE Toni security dhe të ndryshoje arsyet e skualifikimit nga KVO duke e hequr këtë pikë si arsye skualifikimi.

7. Per kundershkrimin e OE ne lidhje me piken gjashte te ankeses ku OE eshte skualifikuar per mos permbushje te kriterit ne lidhje me udhezimin 130 date 05.03.2018 ku duhen certifikatat e specialistit per pergjegjesit e sherbimit per operatoret e sallave dhe vertifikuesve te sinjalit sipas modelit 12 te tij, sqarojme se: OE eshte ankuar per skualifikimin e padrejte pasi nuk eshte vleresuar mbi nje kriter te kerkuar nga ana e AK. KVO ka vleresuar se certifikatat e punonjesve jane detyrim ligjor i mbeshtetur ne udhezimin 130 date 05.03.2018 ku duhen certifikatat e specialistit per pergjegjesit e sherbimit per operatoret e sallave dhe vertifikuesve te sinjalit sipas modelit 12 te tij. Si rrjedhoje ka skualifikuar OE pasi nuk ka paraqitur certifikatat e ketyre punonjesve.

AK ka kerkuar ne kriteret e vecanta, Kapaciteti teknik qe OE te plotesojne kriterin e meposhtem: “Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”

Sipas ketyre kerkesave verejme se AK ka kerkuar qe OE pjesmarres te plotesojne dokumentacionin konform ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhezimit Nr.130 date 05.03 2018 "Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike". Bazuar ne Udhezimin e mesiperm OE duhet te paraqesin dhe certifikatat per punonjesit e sallave dhe verifikuesve te sinjalit pasi eshte udhezimi qe i detyron dhe nuk eshte e nevojshme qe kjo te kerkohet si pike me vete e kriterëve te kualifikimit. Per keto arse KSHA vendosi qe te mos e mare parasysh ankesen e OE “Toni-Security” dhe te lere ne fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

8. Ne lidhje me piken VIII, IX te ankeses se OE mbi pretendimet per operatore e tjere ekonomike "Internacional Security Albania" shpk, "Myrto Security" shpk, "Leksi Security" shpk, "Oktapus" shpk pjesmarres ne kete procedure prokurimi ju sqarojme se: KSHA nuk mund te beje rivleresimin e procedures nga e para pasi OE kerkon qe OE e siperpermendur te rivleresohen nga e para dhe per kete ka paraqitur pretendime te cilat nuk jane te verifikueshme pervec anetareve te KVO-se ne SUT. KSHA nuk mund te japi shpjegim per dokumentacionin e paraqitur nga nje OE dhe ta vere ne dispozicion te nje OE tjeter (OE "Toni -Security").

Per rrjedhoje nuk gjykojme se jemi ne si grup pune qe mund te rivleresojme OE pjesmarres dhe nuk mund te kthejme nje pergjigje mbi dokumentat e OE pjesmarres ne tender. Per keto arse KSHA vendosi qe te mos e marre parasysh ankesen e OE "Eurogjici Security" dhe te lere ne fugi arsyet e skualifikimit nga KVO.

Si përfundim KSHA vendosi që ankesa e "Toni Security" sh.p.k. nuk do të merret parasysh.

II.4.3. Në datën 12.03.2019 operatori ekonomik "Toni Security" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 25.02.2019, operatori ekonomik "Eurogjici Security" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

OE nuk ploteson kriteret e kerkuara:

1-deklarata e gjendjes gjyqesore nuk eshte plotesuar me drejtuesin teknik sipas deklarimeve ne ekstrakin tregetar.

2-eshte nen kosto ligjore. Paga per 1 ore pune nuk eshte perlllogaritur e sakte sipas legjislacionit ne fuqi.

3-Drejtuesi teknik luan shehu nuk figuron ne ekstraktin tregtar te shoqerise. drejtuesi teknik isuf gjici i emeruar ne detyre nuk ka certifikaten e drejtuesit teknik sipas kerkesave.

4-nuk ka grup te gatshem per te tre turnet pasi sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018, kreu 5 menaxhimi i sherbimeve, pika 13 duhen min 2 persona per cdo turn. Sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24ore) dhe 12 muaj sherbim sipas kerkeses.

5- Numri i punonjesve te sherbimit te certifikuar dhe te deklaruar nuk perputhet me numrin e punonjesve te sherbimit sipas kontratave te sherbimit te deklaruar ne drejtorine e policise.

6-Nuk ka vleresim pozitive nga drejtoria e policise. DRP shprehet se nuk ploteson kriteret ligjore sipas kerkesave te ligjit 75/2014 neni 18 pika 1 germa d.

7-Sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018, duhen certifikatat e specjaltetit per pergjegjesit e sherbimit, operoret e sallave dhe verifikuesve te sinjalit. Sipas modelit 12 te tij.

II.5.1. Operatori ekonomik "Eurogjici - Security" sh.p.k. në datën 01.03.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimes kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik "International Security Albania" sh.p.k. si dhe kërkon të mbeten të skualifikuar operatorët ekonomikë "Myrto Security" sh.p.k., "Leksi Security" sh.p.k.

dhe “Oktapus” sh.p.k.. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:

[...]1-Kundërshtojmë arsyen e parë të skualifikimit se... “1-deklarata e gjendjes gjyqesore nuk është plotësuar me drejtuesin teknik sipas deklarimeve në ekstraktin tregtar”. Procedura e prokurimit është zhvilluar në datë 15.02.2019 dhe krahas dokumentacionit të ngarkuar në SPE, shoqëria jonë ka ngarkuar dhe ekstraktin historik të datës 11.02.2019, ku rezulton si drejtues teknik Z. Luan Shehu. Pra në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, rezulton si drejtues teknik I shoqërisë tonë z. Luan Shehu për rrjedhojë edhe shtojca deklarata e gjendjes gjyqesore është plotësuar me këtë drejtues teknik. Ndërkohë që deklarimi në QKB nga shoqëria jonë, mbi të cilin është bazuar autoriteti kontraktor është kryer në datën 18.02.2019, pra 3 ditë pas mbylljes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, për rrjedhojë këto levizje nuk mund të merren për bazë gjatë vlerësimit të dokumentacionit të kësaj procedure. Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...].

Nga sa më sipër na rezulton se skualifikimi i shoqërisë tonë nuk është i bazuar në dokumentat standart të tenderit por në justifikime me qëllim favorizimin e shoqërisë “International Security Albania” sh.p.k. Nga sa më sipër, arsyeja e skualifikimit të shoqërisë tonë është tërësisht në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit, gjenden në QKB në datën e zhvillimit të procedurës (15.02.2019).

2- Kundërshtojmë arsyen e dytë të skualifikimit se ... “2-eshtë nën kosto ligjore. Paga për 1 orë pune nuk është përlogaritur e sakte sipas legjislacionit në fuqi”. Skualifikimi I shoqërisë sonë është tërësisht në kundërshtim me VKM nr.809 datë 26.12.2018, Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi. Në pikën 3 të VKM referuar më sipër është përcaktuar në mënyrë taksative se paga për 1 orë pune është 149 leke. Nga sa më sipër, skualifikimi i shoqërisë tonë është në shkelje të dispozitës së referuar më sipër. Askush nuk ka të drejtë qoftë ky edhe autoriteti kontraktor të marrë përsipër tagrat e Këshillit të Ministrave dhe ligjvënësit. Ligji është i qartë dhe nuk ka nevojë për interpretime dhe keqinterpretime ai thjesht duhet të zbatohet sikundër ka vepruar shoqëria jonë.

2- Kundërshtojmë arsyen e tretë të skualifikimit se ... “Drejtuesi teknik Luan Shehu nuk figuron në ekstraktin tregtar të shoqërisë. Drejtuesi teknik isuf gjici i emëruar në detyrë nuk ka certifikatën e drejtuesit teknik sipas kërkesave”. Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit si tërësisht të pabazuar dhe tërësisht të qëllimshme. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë sonë, ngarkuar në SPE, rezulton se drejtuesi teknik është z.Luan Shehu. Procedura e prokurimit është zhvilluar në datën 15.02.2019 dhe krahas dokumentacionit të ngarkuar në SPE, shoqëria jonë ka ngarkuar dhe Ekstraktin Historik të datës 11.02.2019, pra, 4 ditë përpara zhvillimit të procedurës, ku rezulton si drejtues teknik z. Luan Shehu. Pra në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, rezulton se drejtuesi teknik I shoqërisë tonë është z Luan Shehu. Referuar QKB, drejtuesi teknik i shoqërisë tonë është larguar në datën 18.02.2019, pas datës së hapjes së ofertave. Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezulton se skualifikimi i shoqërisë tonë nuk është i bazuar në dokumentat standart të tenderit por në justifikime të kota që nuk kanë lidhje me gjendjen e kapaciteteve të shoqërisë tonë datën e hapjes së ofertave. Për sa më sipër skualifikimi është i paligjshëm.

4- Kundërshtojmë arsyen e katërt të skualifikimit se... “4-nuk ka grup të gatshëm për të tre turnet pasi sipas udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018, kreu 5 menaxhimi i shërbimeve, pika 13 duhet min 2 persona për çdo turn. Sipas përlogaritjeve dhe parashikimeve në kodin e punës duhet $4.98 \times 2 =$

9.96 persona per 3 turne (24ore) dhe 12 muaj sherbim sipas kerkeses”. Referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“1.Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshëm për periudhën Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo më pak se 42 punonjës shërbimi (me certifikata të vlefshme për 4 vitet e fundit)
- Ka jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi
- Ka grup të gatshëm 24 ore
- Ka jo më pak se 5 operator salla të kontrollit
- Nuk ka masa administrative për subjektin dhe Drejtuesin teknik të shoqërisë për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa të marra për ngjarjet për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Te këto vlerësime pozitive për performancën e subjektit si dhe te këto respektuar legjislacionin në fuqi duke ju përputhur numri i rojeve sipas kontratave të deklaruara në drejtorinë e Policisë me numrin e punonjësve që ka në performance.”

Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

- Vërtetim Nr.143/39 prot, datë 24.01.2019, leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me anë të të cilit theksohet se shoqëria jonë disponon Grup të Gatshëm Turni I, II dhe III. Referuar Udhezimit nr. 130 datë 05.03.2018, kreu 5 menaxhimi i shërbimeve, pika 13 duhet min 2 persona për çdo turn. Ndërkohë që vërtetimi i DVP-Tiranë thekson qartësisht se shoqëria jonë disponon Grup të Gatshëm Turni I, II, III dhe se ka 6 punonjës.

Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezulton se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi i shoqërisë tonë është i bazuar në kriteret të pa kërkuara e për rrjedhojë duhet të anulohet.

5- Kundërshtojmë arsyen e pestë dhe të gjashtë të skualifikimit se... “Numri i punonjësve të shërbimit të certifikuar dhe të dekluar nuk përputhet me numrin e punonjësve të shërbimit sipas kontratave të shërbimit të deklaruara në drejtorinë e policisë.

6-Nuk ka vlerësime pozitive nga drejtoria e policisë. DRP shprehet se nuk plotëson kriteret ligjore sipas kërkesave të ligjit 75/2014 neni 18 pika 1 germa.” Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“1.Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshëm për periudhën Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo më pak se 42 punonjës shërbimi (me certifikata të vlefshme për 4 vitet e fundit)
- Ka jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi
- Ka grup të gatshëm 24 ore
- Ka jo më pak se 5 operator salla të kontrollit
- Nuk ka masa administrative për subjektin dhe Drejtuesin teknik të shoqërisë për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa të marra për ngjarjet për periudhën Janar – Dhjetor 2018

- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”

Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

Vërtetim Nr.143/39 prot, datë 24.01.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me anë të të cilit theksohet se [...]. Ndërkohë që referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit, rezulton të jetë kërkuar: “d) Çertifikata te vlefshme për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 42 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë; keto certifikata duhet te jene te vlefshme sipas ligjit nr. 75/2014 per “Sherbimin privat te Sigurise Fizike”, neni 5 pika 5 dhe Udhezimi nr. 130 date 05.03.2018 “per funksionimin e SHPSF-ve kreu 1 pika 13.” Për përmbushjen e këtij kriteri shoqëria jonë ka ngarkuar në SPE rreth 85 certifikata punonjësish të vlefshme pra dyfishin e numrit të kërkuar më sipër. Pra shoqërisë tonë i përputhet numri i kërkuar nga autoriteti kontraktor prej 42 punonjës shërbimi. Për më tepër referuar Vendimit KPP 42/2019, datë 25.01.2019 i cili thekson [...]. Nga sa më sipër, rezulton se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi i shoqërisë tonë është teresisht i pabazuar në nevojat për realizimin e objektit të prokurimit. Për sa më sipër, skualifikimi duhet të anulohet.

6- Kundërshtojmë arsyen e shtate të skualifikimit se... “7-Sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018, duhen certifikatat e specjalisitetit per pergjegjesit e sherbimit, operatorët e sallave dhe verifikuesve te sinjalit. Sipas modelit 12 te tij”. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“1.Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”

Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria jonë ka paraqitur:

Vërtetim Nr.143/39 prot, datë 24.01.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me anë të të cilit theksohet se shoqëria jonë disponon operator salle minimalisht 5, Përgjegjës Shërbimi 3, Grup të gatshëm 24 orësh Turni I+II+III. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit, del qartë nuk është kërkuar paraqitja e certifikatave të pretenduara nga autoriteti kontraktor. Neni 46, pika 1, germa b e LPP [...]. Neni 53, pika 3 e LPP [...]. Neni 55, pika 2 e LPP [...]. Nga sa më sipër na rezulton se kriteri është përmbushur tërësisht dhe skualifikimi i shoqërisë tonë është i bazuar në kriteret të pa kerkuara e për rrjedhojë duhet të anulohet.

7. Kundershtojme kualifikimin e operatori ekonomik "Internacional Security Albania" shpk, per arsyet ne vijim:

1. Operatori ekonomik ka nderhyre ne formularin e ofertes duke e modifikuar ate te publikuar ne DST. Ne Dst formulari i ofertes.

2. Operatori ekonomik ka ndryshuar preventivin e kerkuar nga Autoriteti kontraktor duke e modifikuar ate.

4. Nuk ka perlllogaritur ne analizen e kostos vleren totale per nje roje ne muaj, vleren per nje vendroje ne muaj si dhe totalin e vleres per numrin total te rojeve dhe afatit te percaktuar. Ne asnje nga Analizat e dy vendrojeve nuk jane bere keto llogaritje. Gjithashtu nuk eshte paraqitur ne Analizen e kostos as totali i vleres per te gjitha vendrojet dhe per afatin e percaktuar.

5. Akoma me tej, nje nder arsyet e skualifikimit te shoqerise sone ishte se... "Sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24 ore). Referuar dokumentave te tenderit, rezulton se sherbimi eshte me tre turne pra 24 ore dhe jo me dy turne per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga DVP-Tirane, per operatorin ekonomik "Internacional Security Albania" shpk, nuk permban punonjes per grup te gatshem 14.94 punonjes sherbimi (4.98×3 Turne (Grup Gatshem 24 ore) = 14.94 persona por me pak se ky numer. Pra, kemi te bejme me favorizim te paster te ketij operatori.

6. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: "1. Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 "Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike" leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018

- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance. "

Ne permbushje te keti kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur: "Vertetim leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane me ane te cilit jepet informacion se Subjekti nuk ka mase administrative (gjoke) POR nuk jep informacion nese ka patur mase administrative ose Jo per Drejtuesin Teknik, kerkese e cila eshte kerkuar ne menyre eksplicite nga autoriteti kontraktor. Per kete arsye operatori duhe te skualifikohet.

7. Data e certificates se drejtuesit teknik te kesaj shoqerie eshte 06.07.2011 nderkohe qe eshte korrigjuar duke e bere 06.07 2015. Pra, kemi te bejme me dokument te skaduar pasi afati I kesaj certificate eshte 4 vjet nga data e leshimit per rrjedhoje nje dokument te pasakt

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, eshte theksuar ne menyre taksative se: Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Raster e mos- dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

8. Referuar Ekstraktit të shoqerise, rezulton se drejtuesi teknik i shoqerise eshte njeheresh edhe administrator cka bie ne kundërshtim me ligjin Nr 75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise" Ne nenin 14, shkronja c) te "Ligjit Nr. 75/2014 "Per SHPSF" theksohet ne menyre taksative se: "drejtuesi teknik te jete i pajisur me certifikaten e nenkategorise 1.3.A dhe te jete me kohe te plote pune." Ne rastin konkret drejtuesi teknik ushtron edhe detyren e administratorit te shoqerise.

9. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: OE ofertues duhet te kete ne stafin e tij te pakten 1 (nje) inxhinier elektronik ose Inxhinier IT i cili te figuroje ne listpagesat e shoqerise. Per te vertetuar kete kriter, OE duhet te paraqese diplome dhe kontrate te vlefshme pune.

Ju sqarojme se:

Operatoret Ekonomike pjesmarres duhet te permbushin kerkesat ligjore sipas Ligjit Nr. 19/2016 PËR MASAT SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE si dhe UDHËZIM Nr.134, datë10.3.2017 "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË MASAVE SHITESË TË SIGURISË DHE LLOJIN MASAVE QË DUHET TË MARRIN SUBJEKTET NË VARËSI TË AKTIVITETIT APO VLERËSIMIT TË RREZIKUT, SI DHE PROCEDURAT E NJOFTIMIT TË TYRE".

AK, për të përmbushur vendimin e lënë nga "DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLICISE SE SHITETIT DREJTORIA VENDORE E POLICISE TIRANE" me shkrese Nr 1885 me date 06.03.2018 dhe protokolluar nga Spitali Univeristar i Traumes me Nr.503 me date 21.03.2018, do te kerkoje, ne kontraten e lidhur me OE te shpallur fitues, qe te monitoroje me kamera territorin e SUT dhe per te realizuar kete duhet te permbushë dhe kriterin e kerkuar me siper (OE ofertues duhet te kete ne stafin e tij te pakten 1 (nje) inxhinier elektronik ose Inxhinier IT i cili te figuroje ne listpagesat e shoqerise). Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e shërbimit por nuk ka paraqitur asnjë licence për të vertetuar se ky person është i licencuar pra ka të drejtë ligjore për të ofruar këtë shërbim.

10. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: "6.OE duhet te disponoje te pakten 7 arme (arme brezi) per te siguruar 7 vendrojet me sherbim 24 oresh sipas specifikimeve teknike ne DT. Per te vertetuar kete pike, OE pjesmarres duhet te paraqesin autorizim/vertetim nga Drejtoria e Policise." Operatori ekonomik ka dështuar në përmbushje të këtij kriteri pasi nuk ka paraqitur autorizim nga DVP-Tiranë.

10. Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitet 2017 dhe 2018, leshuar nga njesite e Qeverisjes Vendore ku OE eshte I regjistruar. Kur konkurrimi behet bashkim operatoresh, secili OE do te sjelle vertetim me vete". Referuar Ekstraktit të shoqerise, rezulton se operatori ekonomik ne daten 21.04.2015, ka hapur adresen: "Tirane, Njesia Bashkiake 9, Bulevardi Zogu i Pare, Pallati Nr 55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap. 9" si në vijim. Ne permbushje te kriterit te mesiperm, referuar informacioneve nga Bashkia, rezulton se operatori ekonomik disponon dhe ka paraqitur dokumentacionin si ne vijim: Vertetim leshuar nga Bashkia Tirane, me ane te se ciles vertetohet vetem shlyerja e taksave vendore per vitet 2015-2016-2017 dhe 2018 per te gjitha adresat ku ka ushtruar aktivitet. Ndërkohë që ky vërtetim nuk ka vertetuar se ka shyer taksat vendore per vitet 2017-2018 per adresen ku ushtron aktivitet. Nga sa me siper, rezulton se operatori ekonomik ka deshtuar ne permbushjen e kriterit kualifikues, për arsye se për adresën "Tirane, Njesia Bashkiake 9, Bulevardi Zogu i Pare, Pallati Nr 55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap. 9", adresë e cila është aktive ende, nuk ka vërtetuar se ka shlyer taksat vendore për vitin 2017-2018.

12. Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: "3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Tetor, Nentor, Dhjetor 2018) , shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 44 punonjës të siguruar në muaj, përfshirë punonjësit e shërbimit roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Rezulton se personi që kryen funksionin e drejtuesit teknik dhe njehekosisht te administratorit nuk është i siguruar ne listpagesat e shoqerise ne te dy pozicionet ate te drejtuesit teknik dhe administratorit. Pra, operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kriterin e vecant te kualifikimit i cili ka kerkuar ne menyre taksative qe te jete i përfshirë drejtuesin teknik dhe administratorin.

13. Operatori ekonomik nuk disponon 44 punonjes me certifikata te vlefshme Brenda afatit 4 vjecare te percaktuar ne nenin 5 te ligjit Nr 75/2014, date 10.07.2014 "Per SHPSF".

14. Certifikatat e punonjesve te shërbimit te paraqitur nga operatori ekonomik nuk figurojne te gjithë ne listpagesat e shoqerise.

15. Rezulton se procedura e prokurimit objekt ankese është hapur ne daten 15.02.2019, nderkohe qe ne faqen zyrtare te Komisionit te Prokurimeve Publike është publikuar Njoftimi Nr. 233 Prot, date 14.02.2019 "Rekomandim mbi menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit per shërbimin privat te ruajtjes fizike" thuhet se: Ne procedurat me afat 1 vjecar ku përfshihet edhe muaji shkurt i vitit 2020 si vit i brishte, mesatarja mujore duhe te përlogaritët 30.5 dite ne muaj; Nderkohe qe referuar diteve mesatare te përlogaritura nga operatori ekonomik nuk jane kryer me 30.5 dite ne muaj per kete arsye duet te skualifikohet.

IX). Kërkojme lenien e skualifikuar te operatoreve ekonomike "Myrto Security" shpk, Leksi Security" shpk dhe "Oktapus" shpk dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit si ne vijim:

Shoqeria "MYRTO SECURITY" SHPK

1. Operatori ekonomik ne Formularin e Ofertes ekonomike ka gabime aritmetike te cilat kalojn vleren 2% dhe oferta duhet te skualifikohet pasi ne rastin konkret nuk pranohen korigjime te gabimeve aritmetike te cilat e kalojne kete vlere. Ne DST është theksuar se: nese ka mosperputhje ndermjet cmimit njesi dhe vleres se pergjithshme qe merret nga shumezimi i cmimit njesi dhe sasise, atehere do te mbizoteroje cmimi njesi, dhe rrjedhimisht duhet te korigjohet shuma ne total. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute te te gjitha korigjimeve jane me shume se 2% e vleres se ofertes ekonomike te ofruar.

Sipas ofertes se Operatorit ekonomik, nese shumezojme cmimin per njesi me afatin dhe sasine del vlere 110,119,891.24 leke (per vendrojen 24 ore). Pra $12 \times 7 \times 4.98 \times 263,243.19 = 110,119,891.24$ leke dhe jo 22,112,428.66 leke sic është llogaritur nga OE. Diferenca midis vleres se sakte dhe vleres se llogaritur nga OE është 88,007,462.58 leke ($110,119,891.24$ leke - $22,112,428.66$ leke = $88,007,462.58$ leke), vlere kjo me e larte se 2% e vleres ekonomike te ofruar. (2% e vleres se ofruar është $22,112,428.66$ leke $\times 2\% = 442,248.57$ leke). Diferenca 88,007,462.58 leke është $> 442,248.57$ leke dhe per kete arsye oferta skualifikohet.

2) Gjithashtu ne rastin e vendrojeve me shërbim 8 ore ka gabim aritmetik, me vlere me te larte se 2% e vleres se ofruar. Sipas logaritjeve te sakta: $12 \times 6 \times 1.08 \times 49,154.04 = 3,822,218.15$ leke dhe jo 3,539,090.88 leke sic është llogaritur nga OE. Diferenca midis vleres se sakte dhe vleres se llogaritur nga OE është 283,127.27 leke ($3,822,218.15$ leke - $3,539,090.88$ leke = $283,127.27$ leke), vlere kjo me e larte se 2% e vleres ekonomike te ofruar (2% e vleres se ofruar është $3,539,090.88$ leke $\times 2\% = 70,781.81$ leke)

3) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Analizen e kostos te plote me perlllogaritje konkrete aritmetikore pasi ne Analize nuk ka llogaritur vleren totale per vendrojet me 4.98 roje dhe me 1.08 roje per 12 muaj si dhe totalin e pergjithshem per numrin total te rojeve dhe afatin e percaktuar.

Shoqeria "OKTAPUS" SHPK

- a) Rezultons se ky operator ka mase administrative ne vertetimin e leshuar nga DVP-Tirane.
- b) Operatori ekonomik ka ndryshuar formularin e ofertes te percaktuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit.
- c) Pra, oferta nuk eshte bere ne perputhje me kerkesat e Autoritetit kontraktor.
- d) Operatori ekonomik ka ndryshuar preventivin e kerkuar nga Autoriteti kontraktor.
- e) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Analizen e kostos te plote me perlllogaritje konkrete aritmetikore pasi ne Analize nuk argumentohet aspak se si eshte perlllogaritur vleren totale per nje roje ne muaj, vleren per nje vendroje ne muaj si dhe vleren totale per te gjitha vendrojet dhe afatin e kerkuar.
- f) Ne preventivin per vendrojet turni i pare, ka lene bosh (pa plotesuar dhe pa argumentuar) 2 rreshtat e shtesave te turneve te cilat jane te detyrueshme per tu plotesuar dhe argumentuar sipas kerkeses se Autoriteti kontraktor ne DST, Shtojca 1-Sqarime. Gjithashtu ka nderhyre ne kete preventiv duke shtuar 2 rreshtat e fundit te cilet nuk jane ne preventivin e kerkuar.

Shoqeria "LEKSI SECURITY" SHPK

- a) Ka mase administrative ne DVP-Tirane.
- b) Operatori ekonomik ka ndryshuar preventivin e kerkuar nga Autoriteti kontraktor.
- c) Ne preventivin per vendrojet turni i pare, ka hequr 2 rreshtat e shtesave te turneve te cilat jane te detyrueshme per tu plotesuar dhe argumentuar sipas kerkeses se Autoriteti kontraktor ne DST Shtojca 1-Sqarime. Gjithashtu ka nderhyre në preventiv duke shtuar 2 rreshtat e fundit te cilet nuk jane ne preventivin e kerkuar.
- d) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Analizen e kostos te plote me perlllogaritje konkrete aritmetikore pasi ne Analize nuk ka llogaritur vleren totale per 7 vendroje me tre turne per 12 muaj, vleren totale per 6 vendroje me nje turn për 12 muaj si dhe vleren totale per te gjitha vendrojet dhe afatin e kerkuar. *Perfundimisht, kerkoje:*
 - 1) Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses.
 - 2) Kualifikimin e shoqerise sone, sipas arsyetimit te dhene me siper.
 - 3) Skualifikimin e operatorit ekonomik "Internacional Security Albania" shp k, sipas referimeve te mesiperme.
 - 4) Lenien e skualifikuar te operatoreve ekonomik "Myrto Security" shpk, "Leksi Security" shpk dhe "Oktapus" shpk, dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit sipas referimeve te mesiperme.
 - 5) Kthim Pergjigje brenda afateve te parashikuara ne nenin 63 te LPP-se.

II.5.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 07.03.2019, me anë të shkresës nr.641/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

"[...]"

Për sa i përket ankesës suaj në lidhje me pikën e parë të saj, ku ankoheni se: arsyeja e skualifikimit është tërësisht në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit, gjendjen në QKB në datën e

zhvillimit të procedurës (15.02.2019) dhe legjislacionin në fuqi, sqarojmë se: Arsyeja e skualifikimit për pikën 1 ka të bëjë me kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe jo ato të vecanta. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është kërkuar që OE ofertues duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit si më poshtë: Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit [...]

Sipas ketyre kërkesave, KVO ka verifikuar vetedeklarimin e plotësuar nga OE "Eurogjici Security" dhe ka konstatuar se drejtuesi teknik nuk është i njëjti me atë që figuron në Ekstraktin historik të shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-se se janë bërë ndryshimet e drejtuesve teknik. Bazuar në këtë informacion, KVO ka vlerësuar se nuk ka të dhëna për drejtuesin teknik të emëruar në datën e zhvillimit të procedurës. Mëson vetedeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës dhe nenit 45 dhe 45/1 të LPP. Për këtë arsye KVO ka vlerësuar se nuk përmbushen kërkesat e AK përsa i përket kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Mëson shqyrtuam këtë informacione, KSHA arsyeton se pretendimet e OE "Eurogjici Security" nuk janë të bazuara në fakte dhe nuk përmbushen kërkesat e përgjithshme të kualifikimit. OE pjesëmarrës duhet të merrnin masë për të plotësuar kushtet e kualifikimit në tender kohe përpara se të zhvillohet procedura në mënyrë që të ketë vlerësim mbi dokumentat e faktit sipas kërkesave në DT. Ndryshimet e ndodhura në datën e zhvillimit të tenderit krijojnë mangësi në dokumentacion dhe për pasojë KVO ka skualifikuar OE që nuk plotësojnë kërkesat e publikuara në DT. KVO ka vlerësuar OE sipas dokumentacionit që ka publikuar në sistemin elektronik të APP-se dhe sipas verifikimeve të vetedeklarimeve sipas shtojcës Nr.8: "Në cdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër". Për këtë arsye KSHA vendosi që të mos e marrë parasysh ankesën e OE "Eurogjici-Security" dhe të lere në fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

2. Përsa i përket pikës së dytë të ankesës së OE "Eurogjici- Security" ku ankohet për skualifikim të padrejtë në lidhje me përlogaritjen e orës minimale bazë për një punonjës (roje) sipas legjislacionit në fuqi, sqarojmë si më poshtë: OE ka bërë përlogaritjet duke u bazuar në pagën minimale bazë në shkallë vendi për të gjithë punonjësit dhe jo mbi pagën minimale për rojet sipas udhëzimeve të APP/KPP si dhe të ligjit Nr. 75/2014 Për SHPSF (ku parashikohet shtesë 50% mbi pagën minimale). Për këtë arsye KSHA vendosi që të mos marrë parasysh ankesën e OE "Eurogjici Security" dhe të lërë në fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

3. Për pikën e katërt ku kundërshtohet arsyeja e skualifikimit e cila ka të bëjë me licencën për drejtuesin teknik pasi dokumentacioni i ngarkuar nga OE në SPE është teresisht sipas legjislacionit në fuqi sqarojmë se: Certifikata e drejtuesit teknik të paraqitur nga OE "Eurogjici - Security" shpik është për drejtuesin teknik të larguar nga kjo detyrë (sipas ekstraktit në QKB) dhe jo për drejtuesin teknik që aktualisht figuron i punësuar në këtë shoqëri. Për këtë arsye KVO e ka quajtur të pa përmbushur këtë kërkesë sipas kriterëve të kualifikimit. OE duhet të dokumentojë se përmbush kërkesat e AK deri në momentin e vlerësimit të dokumentacionit nga ana e KVO-se dhe duhet të kishte marrë masat e nevojshme që të binte ndryshimet përkatëse përpara hapjes së procedurës nga AK. Duke bërë ndryshimet e drejtuesve teknik ku në datën 15.02.2019 figuron si drejtues teknik Isuf Gjici, OE ka bërë të pamundur vërtetimin e dokumentacionit për drejtuesin teknik aktual i cili figuron në ekstraktin e shoqërisë. Për këtë arsye KSHA vendosi që të mos e marrë parasysh ankesën e OE "Eurogjici-Security" dhe të lere në fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

4. Per piken se kater ku kundërshtohet arsyëja e skualifikimit në lidhje me kriteret e vecanta Kapaciteti teknik ku shkruhet se OE nuk ka grup të gatshëm me tre turne pasi sipas udhëzimit nr 130 date 05.03.2018 kreu V, menaxhimi i shërbimeve, pika 13 ku citohet se duhen minimum 2 persona për çdo turn ku sipas përlogaritjeve dhe parashikimeve në kodin e punës duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona për tre turne (24 orë) dhe 12 muaj shërbim sipas kërkesës, sqarojmë se:

OE pretendon se ka përmbushur kriterin e kërkuar pasi në vertetimin e policisë figuron që kjo shoqëri ka grup punonjësish për verifikimin e sinjalit të alarmit. KVO ka vlerësuar se një grup I gatshëm duhet të ketë minimum 2 punonjës shërbimi në çdo turn sipas legjislacionit në fuqi (sipas udhëzimit nr 130 date 05.03.2018 kreu V, menaxhimi I shërbimeve, pika 13 ku citohet se duhen minimum 2 persona për çdo turn). Nisur nga kjo KVO ka bërë përlogaritjet e punonjësve që duhen për një grup të gatshëm me tre turne për 24 orë dhe 365 ditë në vit. Sipas koeficientit të zëvendësimit duhen 1.66 punonjës për çdo turn në një shërbim 24 orësh dhe 4.98 punonjës për tre turne KVO ka verifikuar në rojëve të grupit të gatshëm për çdo turn (2 rojë) dhe e ka shumezuar me koeficientin e rojëve duke vlerësuar se duhen 9.96 punonjës (rojë) për një grup të gatshëm I cili mund të përmbushë kërkesat e AK për një shërbim 24 orësh në 365 ditë.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon se përlogaritja e bërë nga ana e kvo-se është e bazuar në kërkesat e AK për një shërbim 24 orësh në 365 ditë. Për këtë arsye KSHA vendosi që të mos marrë parasysh ankesën e OE “Eurogjici Security” dhe të lere në fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

5. Për kundërshtimin e OE në lidhje me pikën e gjashtë të ankesës e cila ka të bëjë me pikën nr 5-Numri i punonjësve të shërbimit të certifikuar dhe të deklaruar nuk përputhet me numrin e punonjësve të shërbimit sipas kontratave të shërbimit të deklaruar në drejtorinë e policisë. Dhe pikën nr.6 Nuk ka vlerësim pozitiv nga drejtoria e policisë. DSP shprehet se nuk plotëson kriteret ligjore sipas kërkesave të ligjit 75/2014 neni 18.1 germa d, sqarojmë se; Lidhur me ankesën tuaj (për pikën 5 dhe pikën 6 të skualifikimit) ju sqarojmë se KVO ka vlerësuar duke u bazuar në kriteret e kualifikimit si më poshtë:

“Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshëm për periudhën Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhëzimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo më pak se 42 punonjës shërbimi (me certifikata të vlefshme për 4 vitet e fundit)
- Ka jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi
- Ka grup të gatshëm 24 orë
- Ka jo më pak se 5 operator salla të kontrollit
- Nuk ka masa administrative për subjektin dhe Drejtuesin teknik të shoqërisë për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa të marra për ngjarjet për periudhën Janar – Dhjetor 2018
- Të ketë vlerësim pozitiv për performancën e subjektit si dhe të ketë respektuar legjislacionin në fuqi duke ju përputhur numri i rojëve sipas kontratave të deklaruar në drejtorinë e Policisë me numrin e punonjësve që ka në performance.”

Bazuar në kërkesat e mesipërme u verifikua se kvo ka vlerësuar drejtë arsyet e skualifikimit pasi OE nuk i ka përmbushur këto kritere kualifikimi pasi është në kundërshtim me ligjin 75/2014 neni

18 pika 1 germa d, ku shprehet qartesisht se vleresimi i DRP-se nuk eshte pozitiv. Per keto arsye KSHA vendosi qe te mos e mare parasysh ankesen e OE "Eurogici-Security" dhe te lere ne fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

6. Per kundershkrimin e OE ne lidhje me piken gjashte te ankeses ku OE eshte skualifikuar per mos permbushje te kriterit ne lidhje me udhezimin 130 date 05.03.2018 ku duhen certifikatat e specialistit per pergjegjesit e sherbimit per operatoret e sallave dhe vertifikuesve te sinjalit sipas modelit 12 te tij, sqarojme se: OE eshte ankuar per skualifikimin e padrejte pasi nuk eshte vleresuar mbi nje kriter te kerkuar nga ana e AK. KVO ka vleresuar se certifikatat e punonjesve jane detyrim ligjor i mbeshetur ne udhezimin 130 date 05.03.2018 ku duhen certifikatat e specialistit per pergjegjesit e sherbimit per operatoret e sallave dhe vertifikuesve te sinjalit sipas modelit 12 te tij. Si rrjedhoje ka skualifikuar OE pasi nuk ka paraqitur certifikatat e ketyre punonjesve.

AK ka kerkuar ne kriteret e vecanta, Kapaciteti teknik qe OE te plotesojne kriterin e meposhtem: "Vertetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 "Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike" leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruara ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance."

Sipas ketyre kerkesave verejme se AK ka kerkuar qe OE pjesmarres te plotesojne dokumentacionin konform ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhezimit Nr.130 date 05.03 2018 "Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike". Bazuar ne Udhezimin e mesiperm OE duhet te paraqesin dhe certifikatat per punonjesit e sallave dhe verifikuesve te sinjalit pasi eshte udhezimi qe i detyron dhe nuk eshte e nevojshme qe kjo te kerkohet si pike me vete e kriterëve te kualifikimit. Per keto arse KSHA vendosi qe te mos e mare parasysh ankesen e OE "Eurogici-Security" dhe te lere ne fuqi arsyet e skualifikimit nga KVO.

7. Ne lidhje me piken VIII, IX te ankeses se OE mbi pretendimet per operatore e tjere ekonomike "Internacional Security Albania" shpk, "Myrto Security" shpk, " Leksi Security" shpk, "Oktapus" shpk pjesmarres ne kete procedure prokurimi ju sqarojme se: KSHA nuk mund te beje rivleresimin e procedures nga e para pasi OE kerkon qe OE e siperpermendur te rivleresohen nga e para dhe per kete ka paraqitur pretendime te cilat nuk jane te verifikueshme pervec anetareve te KVO-se ne SUT. KSHA nuk mund te japi shpjegim per dokumentacionin e paraqitur nga nje OE dhe ta vere ne dispozicion te nje OE tjeter (OE"Eurogjici -Security").

Per rrjedhoje nuk gjykojme se jemi ne si grup pune qe mund te rivleresojme OE pjesmarres dhe nuk mund te kthejme nje pergjigje mbi dokumentat e OE pjesmarres ne tender. Per keto arse KSHA vendosi qe te mos e marre parasysh ankesen e OE "Eurogjici Security" dhe te lere ne fugi arsyet e skualifikimit nga KVO.

Si përfundim KSHA vendosi që ankesa e “Eurogjici Security” sh.p.k. nuk do të merret parasysh.

II.5.3. Në datën 13.03.2019 operatori ekonomik “Eurogjici - Security” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 2/14 prot., datë 25.03.2019, protokolluar me tonën në datën 29.03.2019, me objekt “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Toni Security” sh.p.k. mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin se: *“nuk ka grup te gatshem per te tre turnet pasi sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018 , kreu 5 menaxhimi i sherbimeve, pika 13 duhen min 2 persona per cdo turn. Sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24ore) dhe 12 muaj sherbim sipas kerkeses [...], si dhe pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici – Security” sh.p.k. mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin se: “nuk ka grup te gatshem per te tre turnet pasi sipas udhezimit nr.130 date 05.03.2018, kreu 5 menaxhimi i sherbimeve, pika 13 duhen min 2 persona per cdo turn. Sipas perlllogaritjeve dhe parashikimeve ne kodin e punes duhen $4.98 \times 2 = 9.96$ persona per 3 turne (24ore) dhe 12 muaj sherbim sipas kerkeses’, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.4 e “Kapacitetit teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. “Vërtetim performance i vitit 2019 (i vlefshem per periudhen Janar-Dhjetor 2018) konform ligjit Nr. 75/2014 “Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhezimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Per funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, i cili verteton se OE:

- Ka jo me pak se 42 punonjes sherbimi (me certifikata te vlefshme per 4 vitet e fundit)
- Ka jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi

- Ka grup te gatshem 24 ore
- Ka jo me pak se 5 operator salle te kontrollit
- Nuk ka masa administrative per subjektin dhe Drejtuesin teknik te shoqerise per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen Janar – Dhjetor 2018
- Te kete vleresim pozitiv per performancen e subjektit si dhe te kete respektuar legjislacionin ne fuqi duke ju perputhur numri i rojeve sipas kontratave te deklaruar ne drejtorine e Policise me numrin e punonjesve qe ka ne performance.”

Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: ”Kryerja e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private në SUT” – Marrveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: Spitali Universitar i Traumes, Laprake, Tirane.

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
7 vendroje 24 oresh	3	4.98 (34.86 roje per 7 vendroje)	12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.
6 vendroje 8 oresh	1	1.08 (6.48 roje per 6 vendroje)	12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici – Security” sh.p.k., për të përmbushur kriterin e mësipërm kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k.

- Vërtetim nr.178/72 prot., datë 13.02.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, mbi performancën e veprimtarisë së shoqërisë “Toni Security” sh.p.k. për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim.

Operatori ekonomik “Eurogjici - Security” sh.p.k.

- Vërtetim nr.143/39 prot., datë 24.01.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, mbi performancën e veprimtarisë së shoqërisë “Eurogjici - Security” sh.p.k. për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.4. Në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 11 dhe 13 është parashikuar:

11. Veprimtaria e SHPSF-së realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit me:

- a) roje objekti për ruajtjen fizike;
- b) truproje për ruajtjen e personave;
- c) sisteme sinjalizuese elektronike për ruajtjen e objekteve;
- d) punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;
- e) punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;
- f) përgjegjës shërbimi;
- g) punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit;
- h) punonjës shërbimi për drejtimin e motoçikletës;
- i) shoqërues i qenit të shërbimit.

13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar ofrimi i shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të Spitalit Universitar të Traumës, shërbim ky i cili kërkohet për 7 vendroje me tre turne dhe 6 vendroje me 1 turn, për një periudhë 12 muaj.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit, ka përcaktuar se operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë nëpërmjet Vërtetimit të performancës të vitit 2019 të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, konform ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhëzimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, se disponojnë grup të gatshëm 24 orë.

Nisur nga kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me grupin e gatshëm, si dhe arsyeja e skualifikimit të dhënë për operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k., KPP referuar Udhëzimit Nr. 130 date 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 13 parashikohet se për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Pra, referuar kësaj dispozite, operatorët ekonomikë kanë detyrimin që të vërtetojnë se kanë grup të gatshëm me 2 (dy) punonjës për çdo turn, për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, sipas shërbimit të kërkuar. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor kërkon ofrimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për 7 vendroje me tre turne dhe 6 vendroje me një turn për një periudhë 12 muaj.

Nisur sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k. konkretisht Vërtetimit nr.178/72 prot., datë 13.02.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, mbi performancën e veprimtarisë së shoqërisë “Toni Security” sh.p.k. për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim, konstatohet se ky operator ekonomik ka deklaruar se ka në dispozicion 9 punonjës për verifikimin e sinjaleve të alarmit, për tre turne. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. konkretisht Vërtetimit nr.143/39 prot., datë 24.01.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, mbi performancën e veprimtarisë së shoqërisë “Eurogjici - Security” sh.p.k. për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim, konstatohet se ky operator ekonomik ka deklaruar se ka në dispozicion 6 punonjës për verifikimin e sinjaleve të alarmit, për turnin e dytë dhe të tretë.

Sa më sipër argumentuar, nisur nga kërkesa e autoritetit kontraktor për grup të gatshëm për 24 orë, ku shërbimi i kërkuar është për 7 vendroje me tre turne dhe 6 vendroje me një turn për një periudhë 12 muaj, si dhe parashikimeve ligjore, ku përcaktohet se ky grup duhet të përbëhet nga minimumi 2 punonjës për çdo turn, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. konstaton se asnjë prej këtyre operatorëve ekonomikë nuk plotëson numrin e nevojshëm të punonjësve për grup të gatshëm për verifikimin e sinjaleve të alarmit, me qëllim ofrimin e shërbimit të kërkuar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues në lidhje me skualifikimin e tyre nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k. mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Eurogjici - Security” sh.p.k. mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. mbi ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.4.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “Eurogjici Security” sh.p.k. mbeten të skualifikuar në bazë të arsyetimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimeve të tyre në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tyre të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tyre i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merren në shqyrtim, pasi operatorët ekonomikë ankimues nuk legjitimohen.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-04187-01-17-2019, me objekt, “Kryerja e shërbimit të ruajtjes me roje private në SUT”, me fond limit 27.018.748 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 15.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 441 Protokolli
Datë 12.03.2019

Nr. 453 Protokolli
Datë 13.03.2019



Public Health Sector

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha